

Në bazë të nenit 3 paragrafi 1 alineja 20 dhe neni 13 nga Ligji për Qendrën Shtetërore të Provimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16 dhe 142/16) neni 10 dhe 11 lidhur me neni 17 nënpika 1.1 të Rregullores mbi mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe të caktimit të lartësisë së kompensimeve autoriale dhe kompensimeve për shërbime të tjera të Qendrës Shtetërore të Provimeve nr. 01-2844/2 nga 05.11.2013, 01-420/2 nga 14.03.2014, 01-2644/3 nga 18.12.2014, 01-344/2 nga 19.06.2015 dhe 01-437/3 nga 17.10.2016 dhe Vendimi për publikimin e konkursit publik për përzgjedhje të bashkëpunëtorëve të jashtëm – vlerësues të testeve nga pjesa eksterne e maturës shtetërore **nr. 02-167/1 nga 21.03.2017**, Qendra shtetërore e provimeve, publikon:

KONKURS PUBLIK **për përzgjedhje të bashkëpunëtorëve të jashtëm – vlerësues**

Qendra Shtetërore e Provimeve – Shkup publikon konkurs publik për përzgjedhje të bashkëpunëtorëve të jashtëm – vlerësues të testeve nga pjesa eksterne e maturës shtetërore në vitin shkollor 2016/2017, nga lëndët:

- *Gjuhë maqedonase dhe letërsi;*
- *Gjuhë shqipe dhe letërsi;*
- *Gjuha turke dhe letërsi;*
- *Gjuhë angleze;*
- *Gjuhë frënge;*
- *Gjuhë gjermane;*
- *Gjuhë ruse;*
- *Matematikë (në gjuhën maqedonase);*
- *Matematikë (në gjuhën shqipe);*
- *Matematikë (në gjuhën turke);*
- *Fizikë (në gjuhën maqedonase);*
- *Fizikë (në gjuhën shqipe);*
- *Fizikë (në gjuhën turke);*
- *Kimi (në gjuhën maqedonase);*
- *Kimi (në gjuhën shqipe);*
- *Kimi (në gjuhën turke);*
- *Biologji (në gjuhën maqedonase);*
- *Biologji (në gjuhën shqipe);*
- *Biologji (në gjuhën turke);*
- *Estetikë / Filozofi (në gjuhën maqedonase);*
- *Estetikë / Filozofi (në gjuhën shqipe);*
- *Filozofi (në gjuhën turke);*
- *Biznes (në gjuhën maqedonase);*
- *Biznes (në gjuhën shqipe);*
- *Biznes (në gjuhën turke);*
- *Histori (në gjuhën maqedonase);*
- *Histori (në gjuhën shqipe);*
- *Histori (në gjuhën turke).*

Vlerësimi i testeve do të bëhet në Shkup, në periudhë **nga 08 deri më 25.06.2017**.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
- të kenë arsimin e lartë adekuat;
- të kenë së paku tre vjet përvojë punë në mësimdhënie;
- të jenë në procecin arsimor në shkollë të mesme në lëndën përkatëse.

Kandidatët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- fletë-aplikim të plotësuar;
- kopje të certifikatës / diplomës për arsimim të lartë adekuat;
- vërtetim që ka realizuar mësimdhënie në lëndën përkatëse, në shkollë të mesme, me vitet e përvojës së punës në arsim.

Fletë-aplikimi mund të shkarkohet nga faqja e internetit www.matura.gov.mk

Fletë-aplikimet me dokumentacionin e paplotë ose të pavlefshme dhe fletë-aplikimet e dorëzuara me vonesë nuk do të jenë lëndë shqyrtimi.

Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e mësipërme do të ftohen për trajnim dhe do të testohen, me çka do të bëhet përzgjedhja përfundimtare.

Kandidatët të cilët nuk do të marrin pjesë në trajnim, nuk do të merren parasysh në procedurën e mëtutjeshme.

Konkursi është i hapur deri më **11.04.2017**

Fletë-aplikimi me dokumentacionin e duhur dorëzohet me anë të dërgesës së rekomanduar postare, në adresën e mëposhtme: Qendra Shtetërore e Provimeve – Shkup, rr. "Vasil Gjorgov" pn, 1000 Shkup, me shenjën **për konkursin publik dhe lëndën për të cilën po paraqiteni.**

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE